



Nr. 220 Prot.

Tiranë, më 04.04.2023

**Drejtuar:** **Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve**  
**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**  
Adresa: Rruga "Ibrahim Rugova", Nr. 4, Tiranë

**Për dijeni:** **Prokurorisë së Përgjithshme**  
Rruga Qemal Stafa Nr.1 Tiranë

**Lënda:** Verifikimi i pastërtisë së figurës të shtetasit Kreshnik Hajdari.

**I nderuar z. Komisioner.**

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për subjekte si më poshtë:

- Deputetë të Kuvendit të Shqipërisë;
- Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave që nuk është deputet;
- Kryetarit të bashkisë apo këshilltarit në këshillin bashkiak;
- Kandidatët për deputet dhe në organet e qeverisjes vendore.

Rezulton se z. Kreshnik Hajdari, aktualisht me funksionin Kryetar i Bashkisë Kuçovë, referuar ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", së bashku me dokumentacionin e kandidimit ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe Formularin e Vetëdeklarimit.

Nga verifikimi i të dhënave në Formularin e vetëdeklarimit të kwtij shtetasi, rezulton se ai nuk ka deklaruar asnjë të dhënë në lidhje me dënime me vendim të formës së prerë nga autoritete gjyqësore shqiptare apo të huaja, dënime me vendime jo përfundimtare nga autoritete gjyqësore shqiptare apo të huaja, masa sigurimi personal, urdhër ndalimi ndërkombëtar, ndalime nga organet ligjzbatuese, dëbime apo hetime brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Në datën 30.03.223 nga mediat është bërë e ditur se shtetasi Kreshnik Hajdari, i datëlindjes

29.07.1982, lindur në Berat, me vendimin nr. 3286 datë 2.06.1999 është dënua nga Gjykata e Shkallës së Parë Janinë, me 4 muaj burg për hyrje të paligjshme në territorin e Republikës Greke.

Ky vendim penal i formës së prerë, pavarësisht veprës dhe masës së dënimit të përmbajtur në të, duhet të ishte deklaruar nga subjekti i vetëdeklarimit z. Kreshnik Hajdari në formularin e sipërpërmendur. Aq më tepër se sikundër rezultoi edhe nga përmbajtja e vendimit ai ka qenë prezent në marrjen e tij dhe rrjedhimisht ka marrë dijeni në mënyrë të menjëhershme lidhur vendimin dhe përmbajtjen e tij.

Ligji Nr.138/2015 dhe Vendimi i Kuvendit Nr.17/2016, përcaktojnë në mënyrë të qartë dhe të detajuar që subjektet kanë detyrimin ligjor të deklarojnë çdo informacion në lidhje me gjenealogjet e tyre aktuale e të mëparshme, rekordet kriminale brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (vendime dënimi përfundimtare ose jo, hetime penale jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, masa sigurimi personale, vendime dëbimi, ndalime arrestime, hetime, etj).


Vendimi Nr.17/2016 i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin Nr.138/2015", është miratuar bazuar në detyrimet ligjore të përcaktuara në ligjin Nr.138/2015. Vendimi nr.17/2016 i Kuvendit ka miratuar formularin e vetëdeklarimit, sipas formatit të përcaktuar në Kreun III-të të tij. Ndërkohë në Kreun III-të, pika 3, germa "ç", parashikohet se "*pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në të, passjell përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo nga funksioni publik*".

Subjekti Kreshnik Hajdari me vullnetin e tij të lirë ka plotësuar Formularin e Vetëdeklarimit, ka nënshkruar në çdo faqe të tij, duke konfirmuar të dhënat që vetë ai ka paraqitur dhe njëkohësisht ka konfirmuar dijeninë e tij në lidhje me parashikimet e Pjesës II-të të Formularit të Vetëdeklarimit (faqe 2) "*Marrja dijeni mbi efektet e formularit dhe të vetëdeklarimit*", ku, ndër të tjera thuhet se: germa "d" "*Pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në këtë Formular dhe refuzimi i depozitimit të gjurmëve daktiloskopike, passjell skualfikimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo ushtrimi i metëjshëm i funksionit publik*".

Nga dokumentacioni i përcjellë, konkludohet se, subjekti nuk ka deklaruar informacionet që lidhen me hetimin dhe dënimin në ngarkim të tij, pavarësisht detyrimit ligjor që buron nga pyetja 3 e formularit të vetëdeklarimit i cili parashikon : "*A keni qenë ndonjëherë në hetim apo gjykim nga një autoritet i huaj për kryerjen e një vepre penale?*".

Duke mos i pasqyruar faktet e mësipërme në formular, konkludohet se veprimi i tij bie në fushën e zbatimit të pikës 3/ç, të KREUT III, të Vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit.

Duke qenë se funksionari publik është përgjigjur me "jo" pyetjeve të formularit të vetëdeklarimit "A keni qenë ndonjëherë në hetim apo ne gjykim nga një autoritet i huaj për kryerjen e një vepre penale?" dhe "A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese për kryerjen e një vepre penale", rezultoi se ai nuk ka deklaruar se ndaj tij ka patur

2  


hetim, ndalim, apo gjykim nga autoritetet ligj zbatuese Greke. Gjithashtu funksionari i është përgjigjur me “Jo” pyetjeve të formularit të vetdeklarimit “A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo?”, dhe “A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj”, rezulton se ai nuk ka deklaruar se ndaj tij ka patur masë shtrënguese e sigurisë personale apo masë dëbimi.

Në lidhje me faktin nëse mosdeklarimi i të dhënave të cilat parashikohen në pyetjet e formularit të vetdeklarimit, përbëjnë shkak për ndalimin e ushtrimit të funksionit Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, është shprehur gjerësisht rast pas rasti dhe në vendimet e mëparshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr.138/2015<sup>1</sup>. Gjithashtu vendimet e KQZ për raste të ngjashme janë ankuar në rrugë gjyqësore dhe Gjykata Administrative i ka lënë në fuqi.<sup>2</sup>

Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2016”. Shprehet se : “.....*Qëllimi i ligjit nr.138/2015, është të garantojë besimin e publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura shtetërore, të institucioneve të pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, si dhe të administratës publike, nëpërmjet pengimit të zgjedhjes ose emërimit në to, apo largimit nga funksioni publik i atyre personave, për të cilët ekzistojnë shkaqet ligjore për të mos u kandiduar, për t’u zgjedhur, apo emeruar, por jo të personave që, për një arsye që nuk lidhet me fshehjen e qëllimshme, kanë referuar të dhëna të ndryshme apo të paplota në raport me të dhënat e gjendura ne regjistrat.*<sup>3</sup> ....)

Sipas interpretimit të Kuvendit vetëm nëse fshehja e të dhënave është e paqëllimshme funksionari nuk është në kushtet për ndalimin e zgjedhjes ose emërimit, apo largimit nga funksioni publik.

Në kuadër të zbatimit të Vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit të Shqipërisë, informacioni i bërë publik dhe i disponuar nga ana jonë (i cili i bashkëlidhet kësaj kërkesë) krijon bindjen se funksionari ka shkelur dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me zbatimin e drejtë, transparencën dhe frymën me të cilën funksionon ligji nr. 138/2015 “Për verifikimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike”, dhe rregullimet e detajuara të parashikuara në vendimin nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë.

Përsa më sipër, kërkojmë nga ana juaj, si autoriteti i ngarkuar nga ligji, që pasi të bëni verifikimet e nevojshme lidhur me pastërtinë e figurës të shtetasit Kreshnik Hajdari të deklaroni se ky i fundit është në kushtet për ndalimin e zgjedhjes ose emërimit, apo largimit nga funksioni publik.

**Përfaqësuesi i Koalicionit  
Endrit Braimllari**


<sup>1</sup> Vendimet e KQZ-së për çështjen G. Rahovica dhe A. Rakipi, respektivisht nr. 3 dhe 4 , datë 5.01.2018

<sup>2</sup> Vendimet e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë nr. 80-2018-4702, datë 24.12.2018 dhe nr. 416(80-2019-432), datë 12.02.2019

<sup>3</sup> Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë (faqe 2)

ΕΛΛΗΝΙΚΗ ΔΗΜΟΚΡΑΤΙΑ  
ΠΡΩΤΟΔΙΚΕΙΟ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ  
ΜΟΝΟΜΕΛΕΣ ΠΛΗΜΜΕΛΕΙΟΔΙΚΕΙΟ  
Αριθμός Απόφασης: 3286/23-6-1999

(Αυτός



ΤΟ ΜΟΝΟΜΕΛΕΣ ΠΛΗΜΜΕΛΕΙΟΔΙΚΕΙΟ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ

(ΠΑΡΑΛΕΙΨΗ)


ΓΙΑ ΤΟΥΣ ΛΟΓΟΥΣ ΑΥΤΟΥΣ:

Δικάζει με παρόντες τους κατηγορούμενους: 1)ΒΙΝΙΑΚΙ JORGJI του SPIRO και της SOFIA, γενν. 13-10-1968 στο ELBASAN Αλβανίας, εργάτη, 2)ΒΙΤΑ ΕΡΙΟΝ του ΑΓΙΜ και της ΗΑΝΟ, γενν. 20-8-1976 στην LUSHNIA Αλβανίας, εργάτη, 3)ΛΑΛΑ FLORANT του LEFTER και της VANJELI, γενν. 20-6-1979 στην VLORA Αλβανίας, εργάτη, 4)ΜΟΥΛΑΙ ΒΕΚΙΡ του ΖΕΚ και της ΜΑΝΕ, γενν. 23-4-1969 στο ΗΑΣ Αλβανίας, εργάτη, 5)ΤΕΡΒΟΛΙ ΣΚΕΝΔΕΡ του ΣΕΦΚΕΤ και της ΦΕΡΙΔΕ, γενν. 13-5-1972 στο ΓΡΑΜΣΗ Αλβανίας, εργάτη, 6)ΤΕΡΒΟΛΙ ΑΡΟΙΑΝΑ του ΝΑΖΜΙ και της ΚΑΜΙΛΕ, γενν. 31-5-1975 στο ELBASAN Αλβανίας, οικιακά, 7)ΑΣΛΛΑΝΙ ΡΑΖΙΕ του ΜΕΔΙ και της ΜΑΜΟΥΔΕ, γενν. 3-6-1944 στο ELBASAN Αλβανίας, εργάτρια, 8)ΑΣΛΛΑΝΙ ΒΙΟΛΛΑ του ΚΑΖΙΜ και της ΖΕΝΕΠΕ, γενν. 29-6-1975 στο ELBASAN Αλβανίας, εργάτρια, 9)ΑΜΑΤΙ ΦΛΟΥΤΡΑ του ΦΑΙΚ και της ΜΕΡΕΜΕ, γενν. 29-1-1954 στο ELBASAN Αλβανίας, εργάτρια, 10)ΑΜΑΤΙ ΔΑΝΙΕΛΑ του ΧΕΜΑΛ και της ΦΛΟΥΤΡΑ, γενν. 27-10-1979 στο ELBASAN Αλβανίας, εργάτρια, 11)ΚΑΝΙ ΚΕΡΙΜΕ του ΚΕΖΑΡ και της ΣΑΒΡΙΕ, γενν. 1-6-1957 στο ΓΡΑΜΣΗ Αλβανίας, εργάτρια, 12)ΚΥΛΛΟΛΛΙ ΛΙΝΔΙΤΑ του ΚΕΜΑΛ και της ΒΑΙΑΜΕ, γενν. 10-2-1972 στο ELBASAN Αλβανίας, οικιακά, 13)ΒΕΡΑΤΙ ΣΙΛΒΑΝΑ του ΚΟΤ και της ΗΑΒΑ, γενν. 4-12-1982 στο ELBASAN Αλβανίας, εργάτρια, 14)ΗΑΙΔΑΡΙ ΚΡΕΣΗΝΙΚ του ΡΙΖΑ και της ΗΑΛΙΜΕ, γενν. 29-7-1982 στο ΒΕΡΑΤ Αλβανίας, εργάτης (ανήλικος συνεκδικαζόμενος), 15)ΒΕΡΑΤΙ ΒΟΥΚΟΥΡΟΣΗ του ΙΛΙΡΙΑΝ και της ΠΡΑΝΒΕΡΑ, γενν. 8-6-1978 στο ELBASAN Αλβανίας, εργάτης, 16)ΦΙΝΟ ΣΚΕΝΔΕΡ του ΣΕΦΚΙ και της ΑΛΕΜΣΗΑ, γενν. 5-1-1956 στο ELBASAN Αλβανίας, 17)ΜΑΡΑΣΗ ΠΛΛΟΥΜ του ΡΡΟΚ και της ΠΡΕΝ, γενν. 1-11-1973 στην ΣΗΚΟΔΕΡ Αλβανίας, εργάτη, και 18)ΚΑΝΙ ΙΟΥΛΙΑΝ του ΣΚΕΝΔΕΡ και της ΚΕΡΙΜΕ, γενν. 1984 στο ΓΡΑΜΣΗ Αλβανίας (ανήλικος συνεκδικαζόμενο).

Κηρύσσει καθέναν από ποινικώς ενηλίκους ένοχο και καθέναν από τους ποινικώς ανήλικους υπαίτιο («τέλεσε πράξη»), της παραβάσεως: Είσοδος στο Ελληνικό έδαφος χωρίς τήρηση των σχετικών νομίμων διατυπώσεων (παραβίαση του άρθρου 4 §§ 1 και 3 του Ν. 1975/1991).

Οι πράξεις διαπιστώθηκαν στο Δεσποτικό του Νομού Ιωαννίνων, στις 23 Ιουνίου 1999, και περί ώρα 02.30'.

Επιβάλλει σε καθέναν από τους κηρυχθέντες ενόχους ποινικώς ενηλίκους κατηγορούμενους: Φυλάκιση Τεσσάρων (4) μηνών.



Ηλεκτρονική σήμανση

Αρ. e-παραβόλου: 576608466953 0927 0061

**APOSTILLE – ΕΠΙΣΗΜΕΙΩΣΗ**

CONVENTION DE LA HAYE 5 OCTOBRE (1961)

Σύμβαση της Χάγης της 5 Οκτωβρίου (1961)


- 1. Χώρα: ΕΛΛΑΣ
- PAYS: GREECE

Το παρόν δημόσιο έγγραφο  
LE PRESENT ACT PUBLIC

- 2. Έχει υπογραφεί από την Αλεξάνδρα Ζούγκου  
ETE SIGNE PAR.....
- 3. Που ενήργησαν με της Γραμματέως Πρωτοδικείου Ιωαννίνων  
AGISSANT EN QUALITE DE .....
- 4. Φέρει την σφραγίδα/επίσημα του Πρωτοδικείου Ιωαννίνων  
EST REVETU DU SCEAU/TIMBRE DE .....

Η Βεβαίωση χορηγείται / ATTESTE

- 5. (Τόπος): Ιωάννινα.
- 6. (Ημερομηνία) 31 Μαρτίου 2023  
AU.....PIREE .....
- 7. Από την Λεμονιά Τσαβίδη, Πρόεδρο Πρωτοδικών του Πρωτοδικείου Ιωαννίνων  
PAR LE TRIBUNAL DE PREMIERE INSTANCE DU PIREE
- 8. ΜΕ ΑΡΙΘΜΟ: 23/ 31-03-2023  
SOUS No:
- 9. Σφραγίδα/επίσημα  
SCEAU/TIMBRE



Υπογραφή  
SIGNATURE  
Λεμονιά Τσαβίδη  
Πρόεδρος Πρωτοδικών

GJYKATA NJËANËTARËSHE E FAJIT TË JANINËS  
(AKT)  
PËR ARSYET E MËPOSHTME:

Vendosi të dënojë në prani të të akuzuarve:

- 1) Jorgji Binjaku i biri i Spiro dhe i Sofia, lindur më 13. 10. 1968 në Elbasan të Shqipërisë, punëtor,
- 2) Erion Bita i biri i Agim dhe i Hano, lindur më 20.08.1976 në Lushnjë, Shqipëri, punëtor.
- 3) Florant Lala i biri i Lefter dhe i Vanjeli, lindur më 20. 06. 1979, në Vlorë, Shqipëri, punëtor.
- 4) Becir Mulaj, i biri i Zek dhe i Mane, lindur më 23. 04. 1969 në Has, Shqipëri, punëtor.
- 5) Skender Tervoli, i biri i Shefqet dhe i Feride, lindur më 13.05.1972 në Gramsh, Shqipëri punëtor.
- 6) Arojana Tervoli, e bija e Nazmi dhe e Qamile, lindur më 31.05.1975 në Elbasan, Shqipëri, shtëpiake.
- 7) Razie Asllani, e bija e Medi dhe e Mamude lindur më 03.06.1944 në Elbasan, Shqipëri, punëtore.
- 8) Vjollca Asllani, e bija e Qazim dhe e Zenepe, lindur më 29.06.1975 në Elbasan, Shqipëri, punëtore.
- 9) Flutura Amati, e bija e Faik dhe e Merjeme, lindur më 29.01.1954 në Elbasan, Shqipëri, punëtore.
- 10) Danjela Amati, e bija e Xhemal dhe e Flutra, lindur më 27.10.1979 në Elbasan, Shqipëri, punëtore.
- 11) Qerime Cani, e bija e Gjezar dhe e Sabrie, lindur më 01.06.1957 në Gramsh, Shqipëri, punëtore.
- 12) Lindita Kullolli, e bija e Qemal dhe e Bajame, lindur më 10.02.1972, në Elbasan, Shqipëri, shtëpiake.
- 13) Silvana Berati, e bija e Qot dhe e Hava, lindur më 04.12.1982 në Elbasan, Shqipëri, punëtore.
- 14) Kreshnik Hajdari, i biri i Riza dhe Halime, lindur më 29.07.1982 në Berat, Shqipëri, punëtor, (i mitur, në gjykim).
- 15) Bukurosh Berati, i biri i Ilirjan dhe i Pranvera, lindur më 08.06 1978 në Elbasan, Shqipëri, punëtor.
- 16) Skënder Fino, i biri i Shefki dhe i Alemsha, lindur më 05.01.1956 në Elbasan, Shqipëri.
- 17) Pllum Marashi, i biri i Rrok dhe i Prenë, lindur më 01.11.1973 në Shkodër, Shqipëri punëtor.
- 18) Julian Cani, i biri i Skender dhe i Qerime, lindur më 1984 në Gramsh, Shqipëri (i mitur në gjykim).



Shpall çdonjërin nga adultët në fajësi penale fajtorë dhe çdonjërin nga të miturit për shkelje penale ("veprim i kryer") për shkelje të ligjit: Hyrje në territorin e Republikës Greke, pa zbatuar formulimet ligjore respective (shkelje e nenit 4 §§ 1 dhe 3 të Ligjit 1975/ 1991.

Aktet u konstatuan dhe u kryen në Despotiko të Prefekturës së Janinës, më dt. 23 qershor 1999 rreth orës 02-30' .

Vendosi për çdonjërin nga adultët penalisht fajtorë të lart përmendur e të akuzuar: Dënimin me katër (4) muaj burg.

Vendosi për çdonjërin nga minorenët e shpallur penalisht fajtorë e të akuzuar: Masën e vendosjes në qendrat e riedukimit.

Shndërron në gjoba monetare të gjitha dënimet me burg të vendosura më sipër për të pandehurit e dënuar (të gjithë) dhe përcakton shumën e konvertimit për çdo ditë burgim në një mijë e pesëqind (1500) dhrahmi.

Urdhëron ekspulsin e menjëhershëm të të gjithë të pandehurve adultë të huaj të dënuar dhe më tej, shtyn në formë të papërcaktuar (sipas nenit 99 parag. 2 të K.Penal) dënimet me burg që u janë caktuar, me kushtin që do të zbatohet menjëherë dënimi i urdhëruar i ekspulsit të tyre.

Urdhëron për secilin nga të pandehurit e deklaruar fajtor: Shpenzimet e procedurës penale në shumën dhjetë mijë (10.000) dhrahmi.

U shpall, u vendos dhe u publikuar menjëherë, në sallën e gjyqit, në një seancë publike, në Janinë, më 23 qershor 1999 .

Gjyqtari i Gjykatës së Fajit  
(Nikolaos Raptis)

Sekretari  
(Michail Vlachos)

Fragment nga Vendimi  
Për përdorim institucional  
Janinë, 23 qershor 1999  
Sekretari  
(firma, vula)  
MICHAIL BLACHOS

Kopje autentike  
Janinë 31.03.23  
Sekretari  
Zougou Aleksandra (firma, vula)

Përktheu nga greqishtja në shqip: Elvis BRAMO

*Elvis Bramo*  
OFFICIAL TRANSLATOR  
CONFERENCE INTERPRETER  
87 20 47 884

**VULË APOSTILE / APOSTILLE**

**KONVENTA E HAGËS E 5 TETORIT (1961)**  
**Convention de la Haye du 5 Octobre (1961)**


1. Vendi **Greqia**  
Pays **GREECE**  
Ky dokument zyrtar shtetëror  
Le présent acte public
2. është nënshkruar nga Z. ALEKSANDRA ZOUGKOU  
a été signé par
3. i cili vepron nën cilësinë e Sekretares së Gjykatës së Shkallës së Parë Janinë  
agissant en qualité de
4. mbart vulën / zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë Janinë  
est revêtu du sceau / timbre de

Ky vërtetim lëshohet / attesté

5. (vendi) Janinë  
à
6. (data) 31 mars 2023  
le Au PIREE
7. nga LEMONIA TSAVIDI, Kryetare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Janinës  
Par
8. me numër 23/31-03-2023  
Sous No
9. Vula / Zyrtare  
Sceau / Timbre
10. Nënshkrimi  
Signature

Lemonia Tsavidi  
Kryetare e Gjykatës së Shkallës së Parë

Përktheu nga greqishtja në shqip: ELVIS BRAMO

  
ELVIS BRAMO  
OFFICIAL TRANSLATOR  
CONFERENCE & INTERPRETER  
01 20 47 224





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER ALMA L. LIMANI



V2023050300047397601

DATE 03/04/2023  
NR REP 971

VËRTETIM PËRKTHIMI

Vertetoj nënshkrimin e përkthyesit z.Elvis Bramo, e biri biri i Emil, lindur më 14/08/1980, në Tiranë dhe banues në TIRANË, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Leternjoftim ID me nr. 033822997 dhe Nr. Personal I00814119D, përthyes i licensuar nga Ministria e Drejtësisë, i cili me deklaroi se perktheu njësoj me origjinalin dokumentin bashkalidhur “Vendim leshuar nga Gjykata Njeanetareshe e Fajit te Janines”, nga gjuha Greke në gjuhën Shqipe.

Unë, noteri, duke gjetur këtë akt në përputhje me ligjin, e vërtetoj atë, në bazë të nenit 135 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”.

NOTER

ALMA L. LIMANI



PULLE TARIFFE

